

NJOFTIM PËR KONSULTIMIN PUBLIK:
BUXHETI AFATMESEM (PBA) 2025-2027, DHE BUXHETI VJETOR I
BASHKISË SKRAPAR DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ “

Në mbështetje të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” në nenin 9 pika 1.3, nenin 34 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar nenin 34 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027, si dhe udhëzimit plotësues nr. 8 datë 05.07.2024 , “Për përgatitjen e programit buxhetore afatmesëm vendor 2025-2027 .

Bashkia Skrapar Njofton: Zhvillimin e konsultimit publik për projekt aktin, buxheti afatmesëm (PBA) 2025-2027 , dhe buxheti vjetor të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj “

Konsultimi publik : Vendi ,në Njësinë Administrative Zhepë/Gjerbës, datë 11.11.2024, ora 9:30

Në Njësinë Administrative Leshnje, datë 11.11.2024, ora 12³⁰

Në Njësinë Administrative Potom, datë 11.11.2024, ora 14⁰⁰,

Në Njësinë Administrative Vëndreshë, datë 12.11.2024, ora 9³⁰,

Në Njësinë Administrative Bogovë datë 12.11.2024, ora 11³⁰,

Në Njësinë Administrative Çepan datë 13.11.2024, ora 10⁰⁰

Për Njësinë Administrative Qendër - Çorovodë datë 14.11.2024, ora 10⁰⁰, në sallën e kinemasë së qytetit Çorovodë “Tefij Lapani”

Pjesëmarrës:

Bashkia Bashkisë: Kryetari i Bashkisë, Grupi Menaxhimit Strategjik, Administratorë të Njësive Administrative, Kryetar të fshatrave, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Këshilli i Bashkisë Skrapar : Kryetarja e Këshillit Bashkisë, Komisioni Ekonomisë dhe Financës, të Këshillit të Bashkisë,

Nga komuniteti: Banorët të Njësive Administrative, grupe biznesi si dhe organizata jo fitimprurëse
Forma e konsultimit: **Takim publik**

Procesverbal i Dëgjesave Publike 2024

Në datën 11.11.2024 në Njësine Administrative Gjerbës- Zhepë, Leshnje, Potom u mbajt dëgjesa publike lidhur me projekt-buxhetin e vitit 2025-2027. Pjesëmarrës në këtë takim ishin punonjës të Njësive Administrative Gjerbës, Zhepë, Leshnje, Potom si dhe banor të fshtarave përkatëse.

Gjatë dëgjesës publike, banorët diskutuan disa problematika të cilat janë:

Gjerbës

1. Infrastruktura: Kërkesa për pastrimin e kanalizimeve dhe rrugëve një herë në vit.
2. Pastrim të kanalit ujitës: Kanali është i prishur dhe ka nevojë për një ndërhyrje të plotë.
3. Pengesë në mes të fshatit: Një përrua prej 100 metrash i cili duhet betonuar për të lehtësuar kalimin e këmbësorëve dhe makinave.
4. Ujësjellësi në fshatin Barç, Strafic: Kërkesa për instalimin e matësave të ujit, pasi menaxhimi i ujit aktualisht nuk është i mirë.

Zhepë

1. Çorrotat, Kovaçaj, Grevë kanë probleme kapakët e pusetave dhe të rikonstruktohen.
2. Dobrenj ka çarje të tubave për shkak të rrjetit të dëmtuar.
3. Ujërat e zeza: Banorët kërkojnë zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza sepse është një problem i vazhdueshëm.
4. Rruga për në Ujanik: Kërkesa për të pasur një riparim të rrugës një herë në vit, për të siguruar kalueshmëri të sigurt.

Leshnje

1. Segmenti i rrugës Leshnje-Vlushë ka nevojë për ndërhyrje.
2. Tubacionet e kohës Enver Hoxhës janë të dëmtuara dhe kërkojnë zëvendësim.
3. Znj. Valbona Gropa shprehu shqetësimin për mungesën e ujit dhe theksoi se është e vetmja familje pa ujë.
4. Familjet që janë larguar nga fshati nuk mund ti paguajnë taksat pasi nuk kanë asnjë të afërm që jeton atje.
5. Puseta e Krastës është e prishur dhe ka nevojë për restaurim të bazamentit.
6. Uji në Vlushë është problem i vazhdueshëm.

Potom

1. Mirëmbajtja e rrugës për lejen e dhënë, kompanive që po shfrytëzojnë pasuritë natyrore për në Zogas.
2. Aksi është emergjent për betonizim në zonën Backë-Potom.

3.Varrezat e fshatit janë dëmtuar një pjesë e tyre janë vjedhur, kërkojnë sistemim dhe rrethimin e tyre.

4.Vendosjen e shtyllave të ndriçimit.

5.Rruga e Gjergjovës ka nevojë për pastrim dhe rregullim.

Dëgjesa publike në Çepan, Vëndreshë,Bogovë u bënë në datën 20.11.2024.

Problematikat e ngritura në **Çepan**:

1.Mirëmbajtja e rrugëve:a) Rog-Çepan, b) Rog-Muzhakë, c) Ura e Blezënkës - Prishtë, d) Ura e Hambullit - Qeshibesë, e) Hambull-Përmet.

2.Kërkesa nga kryepelqtë e fshtarave për rritjen e shpërblimeve, pasi ato janë të papërfillshme dhe banorët nuk janë të kënaqur.

3.Rruga Prishtë-Përmet kërkon pastrim.

4.Rrugët nëpër lagje janë në gjendje të keqe.

5.Në Prishtë banorët nuk lejojnë kalimin e njëri- tjetrit në toka që nuk janë pronë e tyre.

6.Ujësjiellësi në Prishtë, ka familje që marrin ujin direkt nga depoja, ndërsa ka të tjera që nuk kanë fare uji dhe kërkojnë instalimin e matësve dhe rregullim të pushtave.

7.Banorët e Muzhakës kërkojnë mirëmbajtje të rrugës.

Zabërzan

1.Klorinim të ujit.

2.Zhavorë për rrugën.

3.Rruga Zabërzan i Poshtëm - Zabërzan i Lartë nuk i është vënë dorë.

Spatharë

1.Rruga mes lagjeve,Likaj - Kushovallinj ka nevojë për mirëmbajtje.

2.Rruga për tek varrezat dhe lagjia Arapaj duhet të çakullohet.

3.Ujësjiellës: Pushtat duan pastrim, klorinim dhe çdo familje duhet të pajiset me ujë të pijshëm.

4.Restaurimi varrezave.

5.Asfaltimi i rrugës në fisin Begaj.

6.Pagesa e Kryepelqëve.

7.Në Ibrollarë problemet janë: rrugët, varrezat dhe shkolla.

8.Uji i pijshëm: pushtat janë mbushur me rërë.

9.Problem tjetër është linja e energjisë elektrike.

10.Lagjia Aliaj 1 km rrugë për tu pastruar.

11.Rruga Therepel - Vëndreshë II 6 km rrugë dhe për tek varrezat është për tu pastruar.

12.Qendra shëndetësore.

Bogovë

- 1.Në Kakrukë pallatet duhet të suvatohen nga jashtë.
- 2.Rruga e varrezave ka 700-800 m dhe rrugët e brendshme të fshatit Kakrukë kanë nevojë për tu pastruar.
- 3.Çakullim të rrugës së Selanit.
- 4.Pusetat, ndriçimi kanë probleme.
- 5.Në fshatin Bargullas fadroma duhet të punojë për hapjen e rrugëve dhe problem tjetër janë drutë e zjarrit nëpër shkolla.
- 6.Në Grepckë segmenti rrugor prej 100 m ka nevojë për restaurim dhe rregullim të ujit të pijshëm.

Dëgjesa publike në Njësinë Administrative Qendër dhe në qytetin e Çorovodës u bënë në datën 21.11.2024.

Problematikat e ngritura në Njësinë Administrative Qendër dhe në qytet janë:

- 1.Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave Mollas, Liqeth, Grepckë, Vëseshtë dhe Çerricë.
- 2.Problem tjetër në Komunën Qendër ka shumë njerëz të larguar por edhe që kanë humbur jetën por që egzistojnë akoma debitor?
- 3.Mospagim të taksave të tokës sepse nuk janë regjistruar.
- 4.Ndriçimi i rrugës që lidh lagjen “2 Dhjetori” me lagjen “Hasan Seitaj”.
- 5.A ka marrë masa Bashkia për sigurinë nëpër shkolla?

Këto janë problemet që janë ngritur gjatë dëgjesave publike, që kanë nevojë për vëmendje dhe zgjidhje urgjente për përmirësimin e jetesës së këtyre banorëve.

Sekretare Këshillit Bashkiak Skrapar

Xheni ÇELA

